

Fjeti në Zotin motra Argjiro Kondoorgji



Me hidhërim të thellë njoftojmë për fjetjen në Zotin të së nderuarës znj. Argjiro Kondoorgji sot, më 5 gusht 2025, në orën 9:20 të mëngjesit, në prag të së kremtes së Metamorfozës së Shpëtimtarit.

Motra Argjiro ishte bashkëpunëtore besnike e Kryepiskopit të ndjerë të Tiranës dhe të Gjithë Shqipërisë, Fortlumenturisë së Tij, Anastasit, që në punën e tij misionare në Afrikë dhe më pas në Shqipëri. Ajo ndërroi jetë në moshën e shkuar 103-vjeçare, e rrethuar nga njerëzit e saj të dashur.

Shërbesa e Varrimit do të kryhet nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Joani, të enjten, më 7 gusht, në orën 12:00 në Kishën e Manastirit të Ri të Shën Vlashit dhe trupi i saj do të prehet në Skitin e Miroprurëseve të Shenjta, sipas dëshirës së shprehur nga ajo vetë.

I përjetshëm qoftë kujtimi i saj!

* * * *

Argjiro Kondoorgji: Heroina e padukshme e Hierapostullimit Orthodhoks

Argjiro Kondoorgji lindi më 22 shtator 1922 në Tinos. Ishte fëmija i tretë i një familjeje me tre vajza dhe dy djem. Ajo u rrit me besim të thellë nga tezja e saj Ana, e cila përkujdesej për të. Studioi në shkollën Romano-katolike në Tinos, ku u dallua për mprehtësinë e saj. Humbja e nënës në moshën 15 -vjeçare e forcoi edhe

më tej nxitjen për kërkim më të thellë të jetës shpirtërore. Gjatë viteve të pushtimit shërbeu si vullnetare duke ndihmuar të plagosurit e anijes “Eli” dhe më vonë shërbeu edhe si përkthyes me pushtuesit italianë, duke shfaqur guxim dhe patriotizëm të thellë. Pas luftës punoi për 19 vjet në Bankën e Greqisë, por dëshira e zjarrtë për hierapostullimin e jashtëm e bëri të braktiste pozicionin e saj të sigurt në punë në moshën 37-vjeçare, kur dëgjoi thirrjen hierapostolike të teologut - asokohe laik- Anastas Jannullatos.

Argjiro Kondojoorgji ishte bashkëpunëtorja më e ngushtë dhe me vlera e misionarit arkimandrit Anastas Jannullatos, që në fillimet e veprës së tij misionare. Kontributi i saj në zhvillimin e hierapostullimit të jashtëm Orthodhoks në Afrikën Lindore ishte vendimtar dhe i shumanshëm. Ajo organizoi me metodikë arkivin dhe sekretariatin e qendrës hierapostolike në Athinë, shtypi pa u lodhur tekste, studime dhe korrespondencë, mori pjesë aktive në shkrimin dhe redaktimin e revistës “Panda ta Ethni”, si dhe ndihmoi në përkthimin e teksteve në gjuhë të huaja.

Aftësia e saj për të organizuar, klasifikuar dhe menaxhuar vëllime të madha informacionesh dhe dokumentesh ishte e pakrahasueshme. Në të njëjtën kohë, kontribuoi ndjeshëm në organizimin e hierapostullimit në Afrikë, duke mbajtur kontakte me misionarët dhe duke u kujdesur për nevojat e tyre. Përkushtimi dhe puna e saj e palodhur u bënë shumë të njohura ndër ata që e njihnin. Në vitin 1991, kur Episkopi i atëhershëm i Andrusës, Anastasi, u zgjodh Kryepiskop i Tiranës dhe i Gjithë Shqipërisë, Argjiro Kondojoorgji e ndoqi pas që nga momenti i parë në misionin e tij të ri dhe i qëndroi pranë në të gjitha vështirësitë. Megjithëse në moshën gati 70-vjeçare, ajo nuk hezitoi të vinte në Shqipërinë e shkatërruar nga ateizmi, për të vazhduar shërbimin e saj.

Kështu, nisi studimet në Universitetin e Tiranës për të mësuar gjuhën shqipe dhe u mor me përkushtim me organizimin nga e para të Sekretariatit të Kryepiskopatës së Shenjtë të Tiranës. Kontributi i saj në mbështetjen sekretariale dhe funksionimin e zyrës së Kryepiskopit ishte mjaft i rëndësishëm. Për më shumë se tre dekada në vendin tonë, punoi në heshtje dhe pa u lodhur, duke kontribuar me vendosmëri nga ana e saj në rindërtimin e Kishës Orthodhokse të Shqipërisë.

Argjiro Kondojoorgji ishte shumë më tepër sesa një sekretare e thjeshtë. Ajo ishte “kujtesa” i Kryepeshkopit, bashkëpunëtorja që sillte rezultate në nisma të ndryshme, e përkushtuar deri në fund. Një “dhjakoneshë” e Kishës së Krishtit, me vetëmohim, jetë asketike dhe përulësi. Kujtimi i saj do të mbetet i gjallë në zemrat e të gjithë atyre që patën bekimin ta njihnin dhe të bashkëpunonin me të.

“Të lumur që tani janë ata që vdesin më Zotin... që të prehen nga mundimet e tyre; edhe veprat e tyre i ndjekin pas” (Zb. 14:13).

